



Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance	
Agjencia Qendrore e Prokurimit - Centralna Agencija Nabavke - Central Procurement Agency	
Nr. Pro. Org. kodice Org. Gata	AGP
Nr. I Prijave Bt. Shtresa Nra. Prijave	1611
Data: Datum: Date:	
26.03.2019	
Prima mësja e tia	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
*Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance*  
*Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agencija Nabavke-Central*  
*Procurement Agency*

### KONTRATË PËR SHËRBIME

#### TITULLI I KONTRATËS:

Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printereve me qera – Nivel i lokal Lot III

NUMRI I PROKURIMIT: AQP 18 009 211  
NUMRI I MRENDSHEM UA/2016 18 6489 211

Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Nivel i lokal Lot III

**PJESA B: KONTRATA<sup>1</sup> & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**

**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA**

Agjencia Qendrore e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Art House Sh.p.k numër fiskal 600231774 si dhe numrin e biznesit 70273872 (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Titulli: Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal, me numër identifikues: AQP-18-009-211**

UA/2016-18-6489-2-1-1

**Numri rendor i kontratës: 03/19 DPQ**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera për printim, fotokopjim dhe skanim -Niveli lokal

AQP-18-009-211 Lot III- Regjioni III

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga data 01.04.2019.

1.2. Kjo kontrate publike kornize ka kohzgjatjeprej 74 muaj dhe është efektive prej datës në te cilen ajo hyne ne fuqi

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 366.000,00 €; ( Treqinde e gjashtëdhjetë e gjashte mijë ) Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Vecanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

---

<sup>1</sup> Para nënshkrimit te Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartesisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe** në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ekrem Rexha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26/03/2019
Vula:	



Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi :	
Data:	26.03.2019
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	BLIN ZEQIËI
Pozita:	CEO
Nënshkrimi :	
Data:	26.03.2019
Vula:	



**PJESA II E KONTRATES****KUSHTET E PËRGJITHSHME****Neni 1 Përkuqizimet**

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

**Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose .

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit

**Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Nivel i lokal Lot III**

të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### Neni 4

#### Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofroesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5

#### Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofroesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofroesi i Shërbimeve; Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### Neni 6

#### Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një date tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofroesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofroesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofroesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KV. Nëse Ofroesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën

tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në regulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta

përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së konratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së konratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e konratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas konratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas konratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit të konratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të konratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e

**Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Nivel i lokal Lot III**

nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnje detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofroresi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofroresi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelsish të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

#### **Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofroresit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofroresin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 13 Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofroresi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofroresit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofroresit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofroresi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

#### **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofroresi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetit Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroresit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës:

## Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe përmbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jalin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

## Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në

përgjegjësitet e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë sic është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
  - b) ndérprerien e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
  - b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofrojet të Shërbimeve nga depozita, ose me pagesë nga siuria.

Neni 20 Zgħidha migħesore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetërën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do tëjenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KV.K. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila

palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpérblimi

22.1 Ofroresi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpérblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroresit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroresit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroresi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroresi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### PJESA III E KONTRATES      KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</b>
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	

Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Shqipe</b>
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të Shërbimeve është: 60 ditë pas nënshkrimit te kontratës dhe përfundon pas 74 muajve. Kontraktuesi mundet te filloj me implementim te kontrates kur do qe është i gatshem por jo me vonë se 60 ditë pas nënshkrimit te kontratës.
		Dërgesa/sherbimet:  Dorëzimi/sherbimet do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premtë, 8:00-16:00).
Programi	8.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform <b>Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042</b> për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% të vlerës se kontratës me afat validiteti prej 75 muajsh, nga data e nënshkrimit te kontratës. Shuma e sigurisë se ekzekutimit është : <b>36,600.00 ( Tridhjetë e gjashtë mijë e Gjashqinde € ).</b>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesat do të bëhen 15 ditë pas përfundimit te muajit paraprak  Pagesa do të bëhet nga ana e secilit Autoritetit Kontraktues i identifikuar ne baze te UA 06/2016 për shërbime te <b>fotokopjimit, printimit dhe skanimit</b> vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga cilido autoritetet kontraktues i specifikuar ne baze te UA 06/2016.  Kërkesat për pagesë do të bëhet vetëm për Shfrytëzimi i fotokopjeve me qira në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave.  Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzoj tek secili AK i specifikuar e baze te UA 06/2016 një faturë origjinale dhe një kopje për fotokopje/printer të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.  Çdo faturë duhet të përmbarë të paktën informacionin e nevojsphem.
Kontrolli i kualitetit	17.1	AK qe janë shfrytëzuese te kësaj kontrate bajnë pranimin e cekur sipas specifikimit teknik
Zgjidhja miqësore	20.2	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit.

mosmarrëve shjes		Cdo mosmarreveshje ndermjet paleve te cilat mund te lindin gjate ekzekutimit se kesaj kontrate dhe se eshte e mundur te zgjidhet ne menyre miqesore, në mes të zyrtareve përgjegjes të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytezojnë kontraten dhe personat perqjegjes te Furnizuesit me mallra ose shërbime. Nëse dështojnë zgjidhet miqësore të dy palët i drejtohen AQP-së si nënshkrues i kontratës për zgjidhjen e kontestit.
Zgjidhja e mosmarrëve shjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>ne gjykatën kompetente</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

### LISTA E ÇMIMEVE LOT 3

Nr.	Pershkrimi: Sherbimi Pay per Print per AK ne aneksin 7 te DT. Shfrytزم i fotokopjeve dhe printerve me qira për fotokopjim, printim dhe skanim	Njësia matëse faqe e printuar/kopjuar	Sasia e perafert	Çmimi për njësi me tvsh €	Totali me tvsh €
1	Print/Copy A4	1 faqe	60,000,000	€ 0.0061	€ 366,000.0000
Totali me gjithë TVSH					€ 366,000.0000

**Verejtje/Sqarim:**

Ju duhet të plotësoni dhe të dorëzoni çmimet vetëm pasi keni lexuar dhe kuptuar si dhe pranoni që mund të përbushni të gjitha kërkesat e dhëna në Aneks 1 Kushtet e Referimit dhe Specifikacionet teknike të detyrueshme. Në çmimet njësi duhet të përfshini të gjitha shpenzimet si transportin i pajisjeve dhe stafit tuaj, shpenzimet tjera transite/anësore dhe të gjitha pjesëve rezervë përfshirë tonerëve/cartridge, softuer... etj, si dhe koston për secilin shërbim të ofruar: printim, fotokopjim apo skanim.

Ne Çmim do të llogariten sherbimet e fotokopjimit kolor ku per një faqe kolor gjatë kalkulimit do te llogaritet si katër faqe bardh e zi per printim A4 (1xA4Color = 4xA4B&W). Ndersa printimin e A3 aparatet e llogarisin si dy faqe A4. 1xA3B&W = 2xA4B&W

AK shfrytëzuese të kesaj kontrate posedojnë fotokopje të cilat kanë mundësi te integrohen ne sistem me kartela te rrjetit dhe kontraktuesit do ti marrin ne shfrytëzim ato dhe mungesen do ta kompensojnë me sjelljen e aparatave te veta. Aparatet qe janë dispozicion të AK do te mirëmbahen nga kontraktuesi me te gjitha shpenzimet e llagaritura ne çmimin e ofertuar per faqe si ne rastin e aparatit te kontraktuesit pa ndonje ndryshim te çmimit te ofertuar. Aparatet qe posedohen nga AK ne aneksin 7 janë rreth 30 % të sasisë se nevojshme per kryejn e ketyre sherbimeve por kjo varion nga institucion ne institucion dhe mbetet qe kontraktuesit te shtojnë aparatet sipas nevojave te AK pavarsisht se sa është numri i tyre. Ne perfundim të kontrates kontraktuesit do te dorzojnë ne gjendje te rregullt te punës këto aparatet te AK. Keto aparatet do të dorzohen/pranohen nga një komision i AK dhe Kontraktuesit me process verbal me shkrim.

Sasia indikative është perafersisht e saktë, sidomos qoftë kontraktori do të kryej sherbime deri ne perfundimin e kontrates ne kohëzgjatje te lartetur dhe ato sherbime faturohen ne pajtim me permbytjen e kesaj DT. Sasia është sasi e përafert e parashikuar gjatë 6 vjet apo 72 muajve sa do të jetë kohëzgjatja e kontratës AK.

Çmimi per fotokopjim/printim te letres/faqes lejohet te shenohet me maksimum kater (4) numra pas preses dhjetore.

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ART HOUSE SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE OE:	BLIN ZEQIRI
NENSHKRIMI:	
DATA:	28/09/2018
VULJA:	

Numri i Prokurimit: AQP-18-009-211 – Titulli Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerve me gera – Niveli lokal

**PJESA V E KONTRATËS:**

**IDENTIFIKIMI FINANCIAR**

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	ART HOUSE SHPK
Adresa	Bul. Bill Clinton , Dardania Blloku 9/A
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10 000
Kontakti	Fjolla Cavalli
Telefoni	038 549 549
Faks	
E-mail	fjollac@arthousepr.com
Numri i TVSH	330067290

BANKA	
Emri	PROCREDIT BANK
Adresa	Bul. Mother Theresa No. 16
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10 000
Shteti	Republic of Kosovo
Llogaria Bankare	1110420098000131
IBAN (opcionale)	XK05 1110420098000131
BIC (Opcionale)	

**SHËNIME:**



## ANEKSI 7.

### LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE 2

Autoritetet Kontraktuese të cilët kanë të drejtë qe te *leshojne urdhër blerje* sipas kushteve të kontratës kornizë janë si më poshtë:

#### Lot 1 - Regjioni I

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Drenas
2	KK Fushë Kosovë
3	KK Graçanice
4	KK Lipjan
5	KK Obiliq
6	KK Podujeve
7	KK Prishtine
8	Shërbimi i Shëndetit Mendor Prishtine
9	Qendra e Kosovës për Transfuzionin e gjakut
10	Hortikultura Prishtinë
11	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Prishtine
12	Qendra e Mjekësisë Urgjente
13	Qendra kryesore e mjekësisë familjare Prishtinë

#### Lot 2 - Regjioni II

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Deçan
2	KK Gjakovë
3	KK Istog
4	KK Junik
5	KK Klinë
6	KK Peje
7	Spitali Regional Gjakove
8	Spitali Regional Peje
9	Shërbimi i Shëndetit Mendor Gjakove
10	Shërbimi i Shëndetit Mendor Peja
12	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Pejë
13	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Gjakove

<sup>2</sup> Not applicable when the Contracting Authority is not purchasing on behalf of other Contracting Authorities

**Lot 3 - Regjioni III**

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Dragash
2	KK Malisheve
3	KK Mamushe
4	KK Prizren
5	KK Rahovec
6	KK Suhareke
7	Spitali Regional Prizren
8	Shërbimi i Shëndetit Mendor Prizren
9	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Prizren

**Lot 4 - Regjioni IV**

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Ferizaj
2	KK Hani i Elezit
3	KK Kaçanik
4	KK Shterpc
5	KK Shtime
6	Spitali Regional Ferizaj
7	Shërbimi i Shëndetit Mendor Ferizaj
8	Shërbimi i Shëndetit Mendor Shtime
9	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Ferizaj

**Lot 5 - Regjioni V**

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Gjilan
2	KK Kamenicë
3	KK Kllokot
4	KK Novo Berd
5	KK Partesh
6	KK Ranillug
7	KK Viti
8	Spitali Regional Gjilan
9	Shërbimi i Shëndetit Mendor Gjilan
10	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Gjilan

**Lot 6 - Regioni VI**

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	KK Mitrovice
2	KK Skenderaj
3	KK Vushtrri
4	KK Leposaviq
5	KK Zubin Potok
6	KK Zveqan
7	Spitali Regional Vushtrri
8	Spitali Regional Mitrovica
9	Shërbimi i Shëndetit Mendor Mitrovice
10	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës- Mitrovice
11	Universiteti I Mitrovicës ISA BOLETINI

AQP, sipas UA nr. 06/2018 ruan te drejtën që pjesë të këtij aktiviteti të jenë edhe tjera AK te cilët do të sistemohen sipas përkatësisë regionale.

Pjesë përbërëse e policës: 016409

Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: ART HOUSE SHPK, SHESHI BILL KLINTON BLL. 9/9  
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NR I BRENDSHEM UA/ 2016 18 6489 211. NR RENDOR I KONT. 02/19 DPQ

Titulli i aktivititetit të prokurimit: SHFRYTEZIMI I FOTOKOPJEVE DHE PRINTERAVE ME QIRA -NIVELI  
LOKAL LOT 3

Numri i prokurimit: AQP 18 009 211

SIGURIA E KONTRATËS

### Garacion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartçekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke lu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartçekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **36600 EURO (TRIDHJETE E GJASHTE MIJE E GJASHTEQIND EURO)** zotohemti të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:


(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkakluar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **36600 EURO** siç është lartçekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej **26-03-2019 00:00:00** deri **26-06-2025 23:59:59**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

  
\_\_\_\_\_  
SCARDIAN Sigurime  
Rr. Perandori Justinian Nr.3  
10000 Prishtinë  
Kosovë  
2019-03-26 09:54:53







REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIJA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Njësia Org. Org. jedinice Org. Unit	AQP
Nr. Fajqeje Nr. Sifračka Nr. Faxes	1/3
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	55/21
Data : Datum : Date :	01.12.2021
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance, Labour and Transfer  
Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agencija Nabavke-Central Procurement Agency

## AMENDAMENTIMI I KONTRATËS PËR SHËRBIME

### TITULLI I KONTRATËS:

SHFRYTËZIMI I FOTOKOPJEVE DHE PRINTERËVE ME QIRA LOT III – NIVELI LOKAL

NUMRI I BRENDSHEM:AQP / 18 / 009 / 211

**Agjencia Qendore e Prokurimit** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues i cili prokuron në emër të Autoriteteve Kontraktuese të specifikuara ne Aneksin 7"), në njëren anë; dhe

**"ART HOUSE" SHPK** (ne vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira LOT III – NIVELI LOKAL, me numër identifikues: AQP/18/009/211, kanë rënë dakord si më poshtë:

Dispozita e Kontratës Neni 1.2 pika 1 të KPK dhe Neni 6 pika 1 të KVK të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofruesit te Shërbimeve me 26 mars 2019 zëvendësohet / plotësohet si më poshtë:

#### **Neni 1 Lënda e kontratës**

Afat kohor për dorëzimin e shërbimeve është jo më vonë se 60 ditë dhe përfundon pas 6 viteve (72 muaj)

#### **Neni 14.1 Garancia e Ekzekutimit (KVK)**

Afat kohor i Sigurimit të Ekzekutimit është 75 muaj

Ne përputhje me Njoftimin e KRPP-së të datës 10 shtator 2020 (Mbi forcat madhore – Pandeminë) dhe nenin Neni 7 pika 1 germa b dhe Neni 8 pika 2 të KPK, ndryshohet në me sa vijon:

#### **Neni 1 Lënda e kontratës**

Afat kohor për përfundimin e kontratës (për shkak të pandemisë) zgjatet edhe për 6 muaj apo nga 72 në 78 muaj me kusht që para se të vazhdohet edhe për 6 muaj tjerë të vërtetohet se pagesa e shërbimeve për fotokopjim, skanim apo printim nuk duhet ta tejkaloj shumën e kontraktuar .

#### **Neni 14.1 Garancia e Ekzekutimit (KVK)**

Vazhdimi i validitetit të sigurimit të ekzekutimit zgjatet edhe për gjashtë muaj nga data e skadimit të sigurimit të ekzekutimit ekzistues.

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara duke përfshirë edhe sasinë indikativë që nuk do të ketë + apo – 30 %. Ky amendamentim do të jetë pjesë përbërëse e kontratës.

Ky Amendamentim do të hyjë në fuqi vetëm nëse vazhdohet validiteti i sigurimit të ekzekutimit edhe për 6 muaj pas datës së skadimit të këtij ekzistues dhe nëse ofrohet në origjinal së paku 30 ditë ma herët.


Poashtu te Kushtet e Përgjithsme të Kontratës (për shkak të gabimit teknik) shtohet edhe Neni 13.3

#### **Neni 13.3 Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër Te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operator ekonomik:**

**Neni 13.3.1** Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë dhe përshkak të fajt të kontraktuesit e anulon porosinë e ka të drejtën që përvrq për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise edhe ta ritenderon , dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësueset dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

**Neni 13.3.2** Të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendor qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

Hartuar në dy origjinalë, një origjinal për Autoritetin Kontraktues, dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES		PËR KONTRAKTUESIN	
EMRI:	MEHMET RAMA	EMRI:	BLIN ZEQIRI
POZITA:	ZPP	POZITA:	DREJTOR
NËSHKRIMI:		NËNSHKRIMI	
DATA:	01/12/2021	DATA:	01/12/2021
VULA:		VULA:	

PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES	
EMRI:	BEHXHET RRUKIQI
POZITA:	ZKA
NËSHKRIMI:	
DATA:	01/12/2021
VULA:	